Objektet tjera pronë publike në të cilat banojnë familjet , çështja e pronësisë të së cilave është ende e pazgjidhur janë:

Në objektin banesor afër stacionit hekurudhor, çështja e pronës është ende e padefinuar. Në këtë objekt janë të vendosura 23 familje që nga koha e pas luftës. Komuna ka investuar në rregullimin e jashtëm të këtij objekti në mënyrë që të jetë i përshtatshëm për banim. Këto familje janë të identifikuara por çështja ligjore e banimit të tyre ende mbetet e pazgjedhur.



Foto 6. Objekti banesor te Hekurudha" (në të cilën jetojnë 23 familje)

KATEGORITË E SYNUARA

Programin e banimit për tre vitet e ardhshme e kemi filluar nga gjendja ekzistuese dhe duke vazhduar me programet e veçanta për banim që është e rregulluar me ligj.

Ky program planifikohet të jetë i zbatueshëm duke përfshirë numrin e familjeve që do të ndihmohen në tri vitet e ardhshme, mënyrën se si do të ndihmohen në bazë të programeve të veçanta për banim si dhe buxhetin e nevojshëm për realizimin e duhur të këtij programi.

Kategoritë të cilat synohen të përfshihen në program për tre vitet e ardhshme janë kategoritë e familjeve të cilat nuk kanë mundësi buxhetore të sigurojnë banimin sipas kategorive;

1.1 Familje ose individ me gjendje të dobët ekonomike ose përfitues i ndihmës sociale;

1.2 Familje të mëdha me shumë fëmijë dhe familje me një prind;

1.3 Të papunët;

1.4 Të pastrehët;

1.5 Viktima të dhunës në familje;

1.6 Viktima të trafikimit të qenieve njerëzore;

1.7 Gra dhe burra viktima të luftës;

1.8 Familje të dëshmorëve, të të zhdukurve të UÇK-së gjatë luftës

1.9 Invalidët e UÇK-së të cilët janë në gjendje të vështirë ekonomike;

1.10 Invalidë civilë të luftës dhe familjet e ngushta të viktimave civile të luftës, personave të zhdukur,

1.11 Nënata kryefamiljare;

1.12 Persona me nevoja të veçanta, ku do të merren parasysh dhe do të sigurohen kushtet për qasje sa më e lehtë në objekte ;

1.13 Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian;

1.14 Fëmijë bonjakë apo pa përkujdesje prindërore pas daljes nga strehimoret e fëmijëve.

Në bazë të këtij programi do të bëhet regjistrimi dhe shqyrtimi i kërkesave të familjeve të cilët aplikojnë për banim apo përmirësim të kushteve të banimit në bazën e të dhënave, nga ku do të jetë më e lehtë qasja në kërkesat e tyre. Vizitat në shtëpi do të bëhen në mënyrë që të bëhet verifikimi i gjendjes së banimit dhe socio ekonomike.

Komuna e Podujevës planifikon buxhetin ku do të ndërtohen shtëpi për familjet në nevojë në bashkëfinancim me shoqata dhe donatorë të ndryshëm në menyrë që të bëhet zgjedhja e banimit për keto familje.

Do të vazhdojmë bashkëpunimin me donatorë duke propozuar familjet kërkuese në mënyrë që të paraqitet gjendja e tyre.

Sipas Ligjit për Programet e Veçanta të banimit, planifikohet subvencionimi i një pjese të qirasë për familjet që nuk kanë mundësi që të sigurojnë çështjen e banimit dhe kanë nevojë për ndihmë financiare nga Komuna.

Sigurimi i tillë i banimit bëhet përmes financimit të programeve të veçanta të banimit me qira joprofitabile, ku përfshihen:

- Banesat e ndërtuara nga Komuna, Qeveria dhe donatorët të cilat mund të jepen me qira joprofitabile.
- Banesat ekzistuese në pronësi të personave fizikë apo juridikë, të cilat mund të jepen me qira joprofitabile për familjet që posedojnë bonus të banimit.
- Banesat tjera në pronësi të komunës, që mund të adaptohen për shfrytëzim në bazë të programeve të veçanta për banim.

Formë tjetër nga programet e veçanta për banim është edhe ndihma familjeve në nevojë për renovim të shtëpive apo adaptim në objektet për banim.

Familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta për Banim përfshijnë familjet që:

- Nuk kanë banesë apo shtëpi në pronësi individuale.
- Kanë mbetur pa banesë-shtëpi, si rezultat i dëmtimit të shtëpive të vjetra.
- Familjet që posedojnë sipërfaqe banimi nën normat e banimit, të përcaktuara për atë kategori sociale dhe ekonomike.

KRITERET PËR PËRCAKTIMIN E RADHËS SË PËRPARËSISË

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit kriteret e përparësisë për sigurimin e banimit për kategoritë e cekura në pikën 7.1 janë:

- Statusi i banimit
- Lartësia e të ardhurave
- Gjendja shëndetësore
- Invaliditeti
- Struktura e familjes

PLANIFIKIMI KONKRET PËR BANIM SOCIAL

Programi për banim i Komunës së Podujevës është hartuar për periudhën 2026-2028. Komisioni i formuar nga ana e Kryetarit të Komunës ka bërë analizë të gjendjes ekzistuese dhe ka përgatitur propozime konkrete për të ndihmuar qytetarët e Komunës së Podujevës që nuk kanë mundësi të sigurojnë banim. Gjithashtu është themeluar Njësi për Implementimin e Projektit për Banim Social Adekuat (NjIP). NjIP, do të funksionojë si organ kryesor i Implementimit të Projektit përmes nënprojekteve të Banimit Social Adekuat në kuadër të Komunës dhe si ndihmës i organit kompetent

komunal për menaxhimin e kontratave dhe Projektit të Banimit Social Adekuat përmes nën-projekteve

Programi i prezantuar tre vjeçar për Banim ka keto objektiva:

- Implementimi i Projektit për Banim të Përballueshëm i cili është duke u realizuar.
- Implementimi i Projektit për Banim Social Adekuat për Komunën e Podujevës i cili përfshinë tri nën-projektet, dhe tashmë gjendet në fazën e kompletimit të dokumentacionit të aplikuesve. Këto tri nën- projekte përfshijnë:
 - Ndërtimin e Njësive të reja për Banim Social, në lokacionit e propozuar afër Lagjes së Dëshmorëve ku do të përfitojnë përafërsisht 20 familje raste sociale dhe me të hyra të ulëta.
 - Vazhdimi i procesit të punës së Njesitit për Implementimin e Projektit .
 - Rindërtimi i 10 shtëpive dhe renovimi i 40 shtëpive për familjet në nevojë.
- Hapja e Qendrës Rezidenciale për të Moshuar, projekt në bashkëfinancim Komuna e Podujeves me Shoqatën Jetimat e Ballkanit.
- Vazhdimi i ndërtimit të shtëpive për familjet sociale në bashkëfinancim me Shoqatën Jetimat e Ballkanit dhe donatorë.
- Verifikimi i banimit dhe vazhdimi i kontratave për 22 familjet në Lagjen e ndërtuar në bashkëpunim me Fondacionin Firdeus dhe Shqiptarët për Shqiptarët.
- Vlersimin e gjendjes së banimit të familjeve në Lagjen e Dëshmorëve.
- Vizitat dhe vlerësimin e gjendjes tek të gjitha familjet të cilat kërkojnë strehim, ndërtim të shtëpive, riparim apo pagesa për qera.
- Bashkëpunimin me donatorë për të bashkëfinancuar projekte për përmirësimin e kushteve të banimit për qytetare.
- Bashkëpunimi i vazhdueshëm me MMPHI për ndërtim dhe renovim të shtëpive për rastet sociale dhe familjet nga komunitetet.
- Bashkëpunimin me biznese për parteritet publiko privat.

PLANIFIKIMI BUXHETOR DHE REALIZIMI I PROGRAMIT

Për realizimin e Programit trevjeçar për Banim për vitet 2026-2028, Komuna e Podujevës ka bërë planifikim buxhetor në bazë vjetore.

Gjithashtu, në bazë të Memorandumit të Mirëkuptimit të nënshkruar ndërmjet Komunës së Podujevës me MMPHI është duke realizuar Projekti për Banim të Përballeshëm.

Komuna ka nënshkruar Memorandum të Mirëkuptimit me MMPHI për Projektin Banim Social Adekuat ku planifikojmë të realizojmë ndërtimin e Njësisë të re të banimit në parcelën tek Lagjja e Dëshmorëve ku planifikohen të jenë afërsisht 20 njësi banesore.

Si nën-projekt i Banimit Social Adekuat jemi në fazën e kompletimit të dokumentacionit të pronës për familjet individuale për të cilët do të realizohet rindërtimi i 10 shtëpive dhe renovimi i 40 shtëpive në bazë të këtij projekti.

Qendra Rezidenciale për të Moshuar planifikohet të fillojë shërbimet gjatë fillimit të vitit 2026.

Komuna e Podujevës do të vazhdojë kontaktet dhe bashkëpunimin me donatorë të ndryshëm të cilët janë të interesuar të ndihmojnë familjet të cilat kanë nevojë për banim që të ju ndërtohen apo renovohen shtëpive individuale. Kjo është forma më e qëndrueshme për të siguruar banimin për këto familje. Komuna e Podujevës do të vazhdojë të ofrojë informatat relevante dhe do të iniciojë programe në këtë drejtim.

Mënyra e ndihmës	Viti 2026	Viti 2027	Viti 2028	Totali
Shërbimet Rezidenciale	230,000	200,000	200,000	630.000,00

Tabela 5. Buxheti i planifikuar për Shërbime Rezidenciale për vitet 2026 - 2028

Duhet cekur se përveç buxhetit të lartpërmendur të zotuar nga vetë Komuna e Podujevës, do të kërkohet buxhet nga niveli qendror si dhe donatorët.

ANALIZA E FAKTEVE – PËRMBLEDHJE

1.	Qëllimi i hartimit të programit tre vjeçare	Qëllimi kryesor i përpilimit të Programit Trevjeçar në Komunën e Podujevës është që të ndihmohen familjet të cilat kanë nevojë për banim social e nuk kanë mundësi vetanake për të siguruar banim apo përmirësim të kushteve të tyre të banimit.
2.	Baza ligjore	Ky program bazohet në legjislaturën ekzistuese të Republikës së Kosovës të përshkruar në kapitujt e sipërm të këtij dokumenti. Sidoqoftë dy dokumentet kryesore janë; Ligji për Financimin e Programeve të Veçanta për Banim (03/L – 164) dhe Udhëzuesin për Hartimin e Programeve tre vjeçare për Banim. Është i paraparë afati 3 vjeçar të jetë më i përshtatshëm për të hartuar dhe për të dhëne në jetë programet e banimit, duke marrë parasysh veçoritë e Komunës së Podujevës si psh : politikat komunale të banimit (si veçori përkatëse), pozita gjeografike, demografike dhe institucionale.
3.	Llojet e programeve të konsideruara si të nevojshme	<ul style="list-style-type: none"> • Implementimi i Projektit për Banim të Përballueshëm i cili është duke u realizuar. • Implementimi i Projektit për Banim Social Adekuat për Komunën e Podujevës i cili përfshinë tri nën projektet, dhe tashmë gjendet në fazën e kompletimit të dokumentacionit të aplikuesve. Këto tri nën Projekte përfshijnë; <ul style="list-style-type: none"> -Ndërtimi i Njësive të reja për Banim Social, -Rindërtimi dhe renovimi i shtëpive për familjet në nevojë. • Hapja e Qendrës Rezidenciale për të Moshuar. • Vazhdimi i ndërtimit të shtëpive në bashkëfinancim me donatorë për familjet sociale, familjeve me persona me nevoja të veçanta, ku do të merren parasysh dhe do të sigurohen kushtet për qasje sa më e lehtë në objekte, familje nga Komuniteti . • Pagesa e qerasë për familjet në nevojë.
4.	Prezantimi i gjendjes faktike	Aktualisht kemi kërkesa të vazhdueshme për sigurim banimi, ndërtim dhe renovim të shtëpive dhe pagesa për qera nga familjet raste sociale.

5.	Kërkesat faktike për përkrahje me sigurim të banimit	<ul style="list-style-type: none"> • Familjet që nuk kanë banesë apo shtëpi. • Familjet që nuk posedojnë sipërfaqe banimi. • Familjet që janë me kategori sociale, nënat vetushqyese, familje me të hyra të ulta të cilët nuk mund e përballojnë sigurimin e banimit. • Familjet me persona me nevoja të veçanta. • Kategoritë e dala nga lufta ,të riatdhesuarit dhe komunitetet. • Vazhdimi i kontratave për banim të përkohshëm në Lagjen e Re.
6.	Klasifikimi i nevojave sipas urgjencës së trajtimeve te tyre	<p>Do të merren parasysh kriteret e përcaktuara sipas Ligjit nr. 03/L – 164.</p> <p>Do të përdoret Aplikacioni për Mbledhjen e të Dhënave Hapësinore për Banim Social dhe të Përballueshëm</p>
7.	Veprimet kryesore që do të ndërmerren	<ul style="list-style-type: none"> • Implementimi i Projektit për Banim të Përballueshëm i cili është duke u realizuar, projekt ky i cili përfshinë ndërtimin e 133 njësive të banimit, ku 106 do të jenë për banim të përballueshëm ndësa 27 për familje raste sociale. • Implementimi i Projektit për Banim Social Adekuat për Komunën e Podujevës që përfshinë tri nën projektet, i cili tashmë ka filluar dhe jemi në fazën e kompletimit të dokumentacionit të aplikuesve, siq janë; Ndërtimi i Njësive të reja për Banim Social, rindërtimi i 10 shtëpive, dhe renovimi i 40 shtëpive për familjet në nevojë. • Hapja e Qendrës Rezidenciale për të Moshuar. • Regjistrimi i aplikuesve, kompletimi i dokumentacionit të nevojshëm. • Përdorimi i Aplikacionit për Mbledhjen e të Dhënave Hapësinore për Banim Social dhe të Përballueshëm. • Vizita në terren. • Krijimi i listës prioritare për ndihmë sipas mundësive buxhetore. • Nënshkrimi i kontratave me përfituesit e banimit social. • Pagesa e qerasë për familjet që nuk kanë mundësi ekonomike.

8.	Kohëzgjatja e realizimit të programeve	2026-2028
9.	Korniza shpenzimeve afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë	<ul style="list-style-type: none"> • Realizimi i Projektit për Banim të Përballeshëm. • Realizimi i Projektit për Banim Social Adekuat për ndërtimin e Njësive të reja të banimit, rindërtimi dhe renovimi i shtëpive private për familjet raste sociale dhe me të hyra të ulëta. • Hapja e Qendrës Rezidenciale për të Moshuar. • Ndarja e mjeteve buxhetore dhe bashkëfinancimin me donatorë për ndërtimin dhe renovimin e shtëpive, pagest e qerasë në bazë të kërkesave të qytetarëve, ku komisioni do të bëjë vlerësimin dhe përzgjedhjen e familjeve përfituese.
10.	Mundësitë e kapaciteteve njerëzore dhe materiale	<p>Komuna</p> <p>Njësi për Implementimin e Projektit për Banim Social Adekuat(NjIP)</p> <p>Donatorët</p>
11.	Mënyra e financimit të programeve tre vjeçare (të plotësohet më detajisht në dokumentin me programet trevjeçare të banimit)	<p>Buxheti komunal</p> <p>Niveli qendror- MMPHI dhe Ministrinë tjera përkatëse</p> <p>Donatorët</p>
12.	Përputhja e programeve me planet zhvillimore të komunës	PZHK dhe PZHU i miratuar ku janë definuar zonat e banimit

13.	Instrumentet mbikëqyrëse	Zyra e Kryetarit Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis Zyrtari për banim
14.	Instrumentet e garantimit të realizimit të programeve	Monitorimin,raportet, vendimet e Kuvendit Komunal dhe programet e ndryshme të caktuara, raportet nga Njësiti për Implementim të Projektit për Banim Social Adekuat, NjIP.
15.	Transparenca me hartimin dhe zbatimin e programeve	Analizë,debate publike me ekspert të ndryshëm, raportet etj.

INSTRUMENTET MBIKQYRËSE

Formimi i Sektorit të Banimit brenda Komunës së Podujevës i cili do të jetë përgjegjës për të gjitha aktivitetet e planifikuara mundëson që Komuna të ketë mbikqyrje direkte në zbatimin e Projekteve të Banimit. Ky sektor do të raportoj pranë Asamblesë Komunale çdo gjashtë muaj. Po ashtu edhe Ligji e parasheh që MMPHI të mbikëqyrë zbatimin përmes inspektorëve të urbanizmit.

Programi për Banim i Komunës së Podujevës mbulon periudhën 2026-2028. Komisioni ka përgatitur propozimet për projektet prioritare zbatimi i të cilave rezulton në arritjen e synimeve zhvillimore të përcaktuara në fushat kyçe, detyrimet, aktivitetet, bartësit kryesor, afatin kohor të implementimit, përgatitjes dhe koordinimit të aktivitetet të përgjithshme për implementimin e projekteve. Në mënyrë që të sigurojë zbatimin e projekteve të planifikuara do të shqyrtohet mundësia për formimin e Sektorit të banimit i cili do të jetë përgjegjës për koordinimin e të gjitha aktivitetet të planifikuara.

Sektori i banimit është një organ i përhershëm që do të formohet me qëllim të monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të projekteve dhe detyrave nga Programi i banimit, si rishikimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit dhe mbështetjen e Kryetarit të Komunës për marrjen e vendimeve që lidhen me zhvillimin e banimit dhe programet lokale që mbështesin fushën e banimit.

TRANSPARENCA DHE PËRFSHIRJA E PUBLIKUT

Qytetarët kanë të drejtën të informohen rreth mënyrës sesi shpenzohet buxheti i komunës duke përfshirë fushën e programeve tre vjeçare në veçanti. Këto të dhëna do të sigurohen duke përfshirë publikun në procesin e sigurimit të transparencës si:

- zhvillimin e takimeve konsultuese me publikun
- bërja e anketimeve apo studimeve të ndryshme për marrjen e mendimit të publikut;
- bërjen publike të programeve dhe projekteve që përfshijnë ato
- sigurimit të pjesëmarrjes së publikut gjatë diskutimeve që organet përkatëse do të zhvillojnë për hartimin, miratimin dhe zbatimin e programeve
- bërjen e njoftimeve të ndryshme në mjetet e informimit publik apo në vendnjoftimet komunale për aktivitetet ku mund të sigurohet pjesëmarrja e publikut
- çdo masë tjetër e cila vlerësohet e nevojshme në përmbushje të këtij qëllimi

ÇËSHTJET E TJERA

Gjatë hartimit të Programit Trevjeçar të Banimit janë marrë parasysh këto standarde:

- Realizueshmëria;
- Qëndrueshmëria;
- Efektshmëria;
- Mjaftueshmëria e kapaciteteve njerëzore dhe materiale;
- Respektimi i ligjit;
- Barazia;
- Ndikimi në mjedis dhe energjia e pastër;
- Normat e banimit;
- Ndërthurja e këtyre programeve me politikat qendrore të banimit;
- Transparenca;
- Standarde të tjera.

SWOT ANALIZA

PËRPARËSITË	DOBËSITË
<ul style="list-style-type: none"> • Themelimi i Njësitit për Implementimin e Projektit(NJIP); • Projektet nga Qeveria dhe gadishmëria nga Komuna e Podujevës për përmirësimin e kushteve të banimit për grupet e caktuara; • Ekzistimi i dokumenteve të planifikimit hapësinor • Ekzistimi i iniciativave për PPP në fushën e ndërtimeve-banimit; • Infrastruktura në zonat urbane; • Nevoja për zona të reja të banimit; • Ekzistimi i zonave të planifikuara për banim; • Ligjet nga fusha e banimit; • Burimet njerëzore, autoritetet; komunale të përkushtuara për kategoritë e rrezikuara; • Rexhistrimi i popullsisë; • Mbulueshmëria me infrastrukturë; • Strategjitë komunale; • Interesimi i qytetarëve për pjesëmarrje në këto programe. 	<ul style="list-style-type: none"> • Parcela të vogla ose mungesë pronë; • Kosto e lartë e pajisjes me infrastrukturë adekuate; • Kosto e lartë e banimit; • Kapacitete jo të mjaftueshme financiare komunale për zhvillimin e banimit social; • Nuk ka programe të mjaftueshme që ndërmerren për kategoritë e caktuara; • Pronësia e pa definuar; • Mungesa e sektorit për banim pranë DSHMS.
MUNDËSITË	RREZIQET
<ul style="list-style-type: none"> • Ligjet dhe Programet komunale për banim; • Strategjitë shtetërore dhe qendrore; • Formimi i sektorit për banim; • Programet në nivel qendror në mbështetje në nivel lokal nga fusha e ndërtimit/banimit; • Ligjet përkatëse të inkurajojnë zhvillimin e banimi ; • Mbështetje për ndërtimet në pronësi private; • Programe mbështetëse nga partner kombëtarë dhe ndërkombëtarë në fushën e banimit. 	<ul style="list-style-type: none"> • Problemet e vazhdueshme ekonomike dhe financiare; • Mungesa e fondeve në nivel lokal; • Trendi i rritjes së numrit të popullsisë në zonat urbane në raport me planet financiare dhe materiale në fushën e ndërtimit; • Papunësia dhe mungesa e punësimit; • Niveli i lartë i varfërisë.

PËRFUNDIMI

Nevoja për hartimin dhe zbatimin e Planit për banim sipas programeve të veçanta kërkon koordinimin e aktiviteteve të gjithë akterëve në kuadër të Komunës, në përputhje me kompetencat e përcaktuara.

Në këtë drejtim është i nevojshëm formimi i Sektorit për Banim si organi përgjegjës, që në mënyrë aktive të zhvillojë procesin e zbatimit të aktiviteteve sipas këtij Plani. Ndërtimi i njësive të reja të banimit sipas standardeve përmes fondeve nga buxheti komunal, Qeverisë dhe Partneriteti Publik - Privat, që do të siguroj banimin për grupe të caktuara.

Përmirësimi i kualitetit të banimit duke pasur parasysh objektet ekzistuese të banimit kolektiv që në një masë sektori i banimit do të ndikojë në ngritjen e vetëdijes dhe motivimin e pronarëve të njësive të banimit si domosdoshmëri e organizimit dhe menaxhimit.

BURIMI I TË DHËNAVE

- 1.Udhëzuesi për hartimin e programeve komunale trevjçare të banimit;
- 2.Statuti i Komunës së Podujevës;
- 3.Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Podujevës;
- 4.Raportet e Agjensionit të Statistikave të Republikës së Kosovës;
- 5.Raportet e punës së Drejtorive.



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13, 17 shkronja k) dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040, neni 25 paragrafi 1.2 të Ligjit Për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit nr.03/L-164, nenet 16, 19 paragrafi 1.11) dhe 61 paragrafi 1.7) të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, merr:

VENDIM

PËR NGRITJEN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PROGRAMIT TREVJEÇAR TË BANIMIT 2026-2028 NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Për hartimin e propozimit të Programit trevjeçar të banim në Komunën e Podujevës për periudhën kohore 2026-2028, ngritet Grupi punues në këtë përbërje;

1. **Blerina Zeka** zyrtare - Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit kryesuese
2. **Arbresha Bashota** zyrtare - Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale anëtare
3. **Florie Humolli** zyrtare - Drejtorja e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë anëtare

Neni 2

Grupi punues, harton propozim programin trevjeçar të banimit, në pajtim me dispozita e Ligjit nr.03/L-164 Për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit dhe aktet tjera përkatëse nënligjore në fuqi.

Neni 3

Për punën, detyrat dhe përgjegjësitë grupi punues informon në formë të shkruar Kryetarin e Komunës përmes Drejtorit/eshës së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:
Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
Anëtarëve të Grupit
Zyrës së Personelit
QSHQ/Arkivit

Nr. prot. 02-020/18-100257/26
Podujevë, datë: 05.02.2026

Kryetari i Komunës
Shpejtim Buliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11 dhe 13 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, nenit 23.3 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.04/2023 Për Administratë të Hapur në Komunë dhe nenet 14, 16 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.prot.01-020/01-0050862/18, merr;

VENDIM PËR VËNIE NË KONSULTIM PUBLIK

Neni 1

Vëhet në konsultim publik:

- **Draft Programi Trevjeçar i Banimit 2026-2028**

Neni 2

Diskutimi publik sipas këtij paragrafi, zgjat 30 ditë përkatësisht prej datës, **24.02.2026 deri më 24.03.2026**, brenda së cilës Grupi Punues për hartimin e **Draft Programit Trevjeçar të Banimit 2026-2028**, mund të organizoj diskutime/konsultime të ndryshme publike, kurse **Debati i përgjithshëm publik me qytetarë mbahet më 11.03.2026, duke filluar nga ora 10:00, në ndërtesën e re të Komunës, kati përdhës - salla e mbledhjeve.**

Neni 3

Propozimet, sugjerimet, apo vërejtjet eventuale paraqiten gjatë debateve publike, gjithashtu në formë të shkruar mund të paraqiten gjatë kohëzgjatjes së diskutimit/konsultimit publik në Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, ndërtesa e re e Komunës zyra nr.54, si dhe në formë elektronike mund të dërgohen në e-mail adresën; **arbresha.bashota@rks-gov.net** të cilat pastaj përcjellën në Zyrën përkatëse, brenda periudhës së diskutimit/konsultimit publik.

Neni 4

Dokumenti sipas nenit 1, është pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe i njëjti publikohet në ueb-faqen zyrtare të Komunës: **<http://kk.rks-gov.net/podujeve>** (rubrika; **aktet për diskutim publik**) dhe në lokalitete të ndryshme aty ku Komuna e vlerëson të nevojshme.

Neni 5

Konsultimi/debati publik zbatohet nga Grupi Punues për hartimin e **Draft Programit Trevjeçar të Banimit 2026-2028**, në bashkëpunim dhe koordinim me Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, që përkujdeset për përgatitjen e raportit nga konsultimi dhe debati publik dhe të jap sqarime për arsyeshmërinë e pranimit ose mospranimit të propozimeve dhe sugjerimeve konkrete.

Neni 6

Pas shqyrtimit dhe miratimit, Vendimi hyn në fuqi pas 7 ditë pas publikimit ueb faqen zyrtare të Komunës.

Nr.prot. **02-016/01-0011237/26**
Podujevë, datë: **26.02.2026**





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva
Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Nr. Prot. 06-016/01-0018265/26

Datë: 11.03.2026

PROCESVERBAL

Debati publik me qytetarë: Prezantimi i Draft Programit Trevjeçar të Banimit 2026–2028, i organizuar nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Vendi i mbajtjes së takimit: Salla e mbledhjeve, Kuvendi Komunal i Komunës së Podujevës

Takimi filloi në ora 10.00 dhe përfundoi në ora 10.45.

Të pranishëm ishin qytetarë nga shoqëria civile, përfaqësues nga Komunitetet, përfaqësues nga HANDIKOS, z. Fahri Restelica, Nënkyetar i Komunës së Podujevës, znj. Lirie Hoti, Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Blerina Zeka, kryesuese e komisionit dhe zyrtare në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Arbresha Bashota, anëtare, si dhe zyrtare nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Florie Humolli anëtare e komisionit, zyrtare nga Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë.

Diskutimin e hapi znj. Lirie Hoti, Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, e cila theksoi se komisioni ka punuar me këtë program, në mënyrë që të kemi të dhëna gjithëpërfshirëse dhe të jemi të informuar lidhur planet, propozimet dhe sfidat me Programin Trevjeçar të Banimit 2026–2028. Znj. Hoti Rama theksoi se i pranishëm është edhe Nënkyetari i Komunës z. Fahri Restelica për të dëgjuar sugjerimet e juaja, dhe kërkoi nga pjesëmarrësit të japin kontributin e tyre për këtë çështje të një rëndësie kaq të madhe për të gjithë qytetarët.

Znj. Florie Humolli, anëtare e komisionit, si dhe zyrtare nga Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë e prezantoi punën e komisionit në përpilimin e programit të një rëndësie të veçantë duke vlerësuar se qëllimi i programit trevjeçar të banimit social në Komunën e Podujevës është të identifikojë problemet e banimit në këtë Komunë, dhe të paraqes politikën dhe planifikimet në zgjedhjen e këtyre çështjeve. Ky program synon të krijoj politikë dhe zgjedhje për qytetarët që nuk kanë mundësi ekonomike për të siguruar banim me çmim të tregut. Realizimi i këtij programi do të bëhet përmes fondeve komunale, investimeve nga niveli qendror dhe

donatoreve. Vizioni i programit është përmirësimi i cilësisë së jetës së qytetarëve. Komuna synon të sigurojë kushte më të mira jetësore për të gjithë komunitetet. Qytetarët duhet të kenë banim të përshtatshëm dhe mundësi të barabarta. Po ashtu synohet të tërhiqen edhe investime dhe të zvogëlohet numri i familjeve që kanë nevojë për banim social. Objektiv kryesor është edhe krijimi i kushteve për banim të qëndrueshëm dhe sipas standardeve evropiane. Programi synon të ndihmojë individët dhe familjet që nuk kanë mundësi ekonomike për të përballuar banimin në tregun e lirë. Këto objektiva janë në përputhje në parimet e planifikimit të qëndrueshëm. Gjithashtu, ajo përmendi edhe sfidat si p.sh. buxheti i pamjaftueshëm për zhvillimin e banimit social si ndërtime, renovime të shtëpive ose pagesë të qirasë. Shumë qytetarë përballen me mungesë të pronësisë. Kostoja e banimit është e lartë prandaj shumë familje nuk mund ta përballojnë. Shkalla e papunësisë është e lartë, gjë që e vështirëson sigurimin e banimit. Në vazhdim identifikohen raste të reja të familjeve që kanë nevojë për banim social. Si përfundim ky program synon të siguroj kushte më të mira banimi dhe një jetë më të mirë për të gjithë qytetarët. Znj. Arbresha Bashota, anëtare e komisionit, si dhe zyrtare nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale shpjegoi se kanë punuar sipas procedurave administrative të Ligjit për banim, Ligjit për programe të veçanta të banimit. 2026-2028. "Por, sfidat janë të mëdha për banim në përgjithësi në Kosovë, e gjithashtu edhe në Podujevë, mungesa e buxhetit, mungesa me dokumentet e pronësisë, si dhe numri i rasteve sociale të cilat kanë nevojë për banim. Në Programin Trevjeçar kemi bërë përpjekje të përfshijmë projektet të cilat janë realizuar që tri vitet e fundit dhe ato të cilat janë duke u realizuar dhe planifikohen të realizohen në tri vitet e ardhshme, si p.sh. realizimi i projekteve me shoqatën "Jetimat e Ballkanit", ku Komuna ka arritur marrëveshje bashkëfinancimi me këtë shoqatë dhe donatorë tjerë dhe nga kjo marrëveshje ka rezultuar ndërtimi i shtëpive për rastet sociale dhe komunitet. Ne gjithmonë mundohemi t'i përfshijmë të gjithë pa dallime. Në vitin 2024 Komuna e Podujevës ka nënshkruar marrëveshje me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), projekti për banim të përballueshëm njësitë banesore sa kanë filluar të ndërtohen, 70 % e tyre kanë me qenë për çifte të reja, ndërsa 30 % do të jenë të dedikuara për raste sociale. Aplikimi nga familja do të bëhet kur të realizohet ndërtimi. Gjithashtu, Komuna ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me MMPHI për banimin adekuat ku planifikohet të ndërtohen njësi banimi sociale në lokacionin "Lagjja e Dëshmorëve", renovimi dhe ndërtimi i shtëpive, ku do të përfshihen edhe familje nga komunitetet tjera. Të pranishmit vlerësuan rëndësinë e përfshirjes së kategorive sociale, dhe atyre me nevoja të veçanta në projektin në fjalë. Z. Xhafer Ademi përfaqësues i Komitetit për Komunitete ndër të tjera vlerësoi se programi është shumë i rëndësishëm, por apeloj që në mënyre që programi të realizohet nevojitet të sigurohet buxheti nga niveli lokal dhe ai qendror. Po ashtu ai theksoi se çështja e banimit të komunitetet e sidomos të komuniteti rom ku nuk kanë hapësirë të mjaftueshme të banimit është e rëndësishme ku kërkoi përfshirjen e tyre në sigurim të përmirësimit të kushteve të banimit.

Znj. Hoti Rama theksoi se propozimet e parashtruara do ti kemi parasysh dhe do të bëjnë përpjekje të vazhdueshme për sigurimin e banimit për komunitete duke përfshirë edhe ndihmën e donatoreve që t'i dalim në ndihmë komunitetit, por edhe pjesës tjetër të qytetareve të Podujevës, duke synuar kështu që shumë shpejt në Podujevë mos të jetë më problem çështja e banimit.

Naime Podvorica, zyrtare për Barazi Gjimore kërkoj nga komisioni të dhëna statistikore për gjendjen reale të numrit të rasteve sociale në mënyre që të paraqitet gjendja dhe te behet planifikimi.

Në vazhdim u paraqitën propozime shtesë nga pjesëmarrësit, të cilët theksuan nevojën për përmirësimin e kriterëve të përzgjedhjes dhe rritjen e mundësive për përfshirjen e familjeve në kushte të rënda sociale. Idriz Hoxha, përfaqësues i shoqatës "Handikos", dega në Podujevë, kërkoj përmirësim të infrastrukturës për personat me aftësi të kufizuara.

Blerina Zeka, kryesuese e komisionit dhe zyrtare në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit duke ju përgjigjur z. Hoxha njoftoi se sa i përket ndërtesave të cilat do të punohet në vertikale patjetër se do të përfillën normat kryesore teknike për persona me aftësi të kufizuara si rampat, trajektorët për personat që janë të verbër dhe ashensorët.

Z. Osman Bajrami zyrtar në zyrën ligjore i kërkoj nga z. Hoxha që te njoftohen qytetaret për mundësitë dhe vërejtjet, sugjerimet t'i dërgojnë tek komisioni. Ndërkohë, nënkryetari z. Fahri Restelica në lidhje me temën kërkoj që të adresohen problemet e personave me aftësi të kufizuara dhe se ato mos të përsëriten nga viti në vit. Në fjalën përmbyllëse drejtoresha e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale znj. Lirie Hoti falënderoi të pranishmit duke i njoftuar se për çdo propozim, vërejtje dhe sugjerime për Draftin Trevjeçar të Banimit të vizitohet ueb faqen e Komunës, dhe se ato mund ti adresojnë në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale".

Podujevë, 11.03.2026

Procesmbajtës

Minire Zhitia

**Zyrtare për Arsim, Drejtorja e Arsimit
Komuna e Podujevës.**





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosova

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva


DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENJE SOCIALE

Lista e pjesëmarrësve në takimin me publikun për Programin Trevjeçar të Banimit

2026-2028, datë 11.03.2026 ora 10.00.


Nr.	Emri dhe mbiemri	Nënshkrimi
1	Naime Podivonica	<i>Naime</i>
2	FITORE BLAKÇORI	<i>Fitore</i>
3	Naime Gringorin	<i>Naime</i>
4	Hamide Jashari	<i>Hamide</i>
5	LIRIDONA PRAHMANI	<i>Liridona</i>
6	Naschije Haliti	<i>Naschije</i>
7	Pajtonë Saoliku	<i>Pajtonë</i>
8	Qendresa Shala	<i>Qendresa</i>
9	Shyrex Maloku	<i>Shyrex</i>
10	Arjana Bulliqi	<i>Arjana</i>
11	Albina Rudari	<i>Albina</i>
12	Gresa Jaholl	<i>Gresa</i>
13	Shkurte Musa	<i>Shkurte</i>

14	Ahben Henni	Haris
16	Ylber Salihu	Ylber
17	FAIK TAHIRI	FAIK
18	Jariz Hoxha	Haris
19	Jafan Ucq	Ucq
20	RAZIT HAZIRI	Razit
21	Liman (Fegjiri)	Liman
22	Muhamed Sasika	Muhamed
23	Kraser Ademir	Kraser
24	Rochim Sejdiu	Rochim
25	Behar Ahmeti	Behar
26	BLERNA ZEKI BILAJA	Blerina
27	FLORIE BEHE HUMOLLI	Florie
28	Xhufijone Namoni	Xhufijone
29	Arbresh Bisheta	Arbresh
30		
31		
32		
33		
34		
35		
36		
37		





Kuvendi i Komunës së Podujevës







Kuvendi i Komitës së Podujevës












oduljevės





**DRAFT PROGRAMMI
TRIVJEĆAR I BANIMIT**

2014-2016





Kūvenīfi i Komunēs sē Podujēvės





Re: Komentet në Draft Programin Trevjeçar të Banimit (2026–2028)

Arbresha Bashota

Ekrem Rrahmani; Lirie Hoti; Blerina Zeka; Florie Humolli

Përshëndetje i nderuar,

Komentet tuaja lidhur me Programin Trevjeçar të Banimit 2026-2028 janë të mirëpritura dhe do të meren në konsideratë për përfshirje në këtë Program.

Si komision dhe si DSHMS, të falënderojmë për kontributin tuaj,

Me shumë respekt,

Arbresha

From: Ekrem Rrahmani

Sent: Tuesday, March 24, 2026 10:16 PM

To: Arbresha Bashota

Subject: Komentet në Draft Programin Trevjeçar të Banimit (2026–2028)

Get [Outlook for iOS](#)

Komentet në Draft Programin Trevjeçar të Banimit (2026–2028)

Korrigjimi i të dhënave

Te kategoria “Profil i komunës së Podujevës” – pozita gjeografike (vendbanimet), të dhënat e paraqitura nuk korrespondojnë me ato të Regjistrimit të Popullsisë (2024), si p.sh.:

- Kur nxirret numri i banorëve që jetojnë në fshat, del se janë 73.5%, ndërkaq, në realitet, nga 70,975 banorë, në fshatra jetojnë 50,645 banorë, që në përqindje i bie 71.35%.

Ngjashëm, edhe te banesat ka diferenca me Regjistrimin e Popullsisë (2024):

- Ju i referoheni 12,315 objekteve të banimit në Komunën e Podujevës (7,891 në zonat rurale dhe 4,424 në zonat urbane);
- Referuar tabelës “Ndërtesat sipas llojit, tipit të vendbanimit dhe komunave 2024”, del se në zonat rurale janë 10,058, ndërkaq në zonat urbane janë 3,483, që në total bëjnë 13,541.

Struktura e dokumentit

Në draft-planin trevjeçar të banimit, referoheni se dokumenti bazohet në Udhëzuesin për Hartimin e Programeve Trevjeçare për Banim. Sigurisht, do të ishte e pritshme të ketë detaje mbi këtë udhëzues, por nëse i referoheni “Udhëzuesit për Hartimin e Profilit Komunal të Banimit”, hartuar nga UN-Habitat në vitin 2014, ky draft-program nuk ka inkorporuar shumë elemente, përfshirë:

- Profil të plotë të fondit të banimit (gjendja, cilësia, tipologjia, shpërndarja);
- Analizë të përbalueshmërisë (të ardhurat vs. kostoja e banimit, qiraja, energjia);
- Analizë të kërkesës dhe projeksione afatmesme/afatgjata;
- Ndarje të grupeve të synuara (profil socio-ekonomik, madhësia);
- Analizë të tregut të banimit (oferta dhe kërkesa, roli i sektorit privat);
- Integrim me planifikimin hapësinor (tokë, zonim, PZHK);
- Analizë të kapaciteteve institucionale për zbatim;
- Sistem të qëndrueshëm të të dhënave dhe indikatorëve;
- Kornizë të qartë të priorizimit strategjik, bazuar në evidencë;
- Lidhje të strukturuar ndërmjet Profilit, Strategjisë dhe Programit.

Paqartësi të kërkesat faktike për përkrahje

Në tabelë nuk paraqiten qartë të dhënat se si ka qenë kërkesa ndër vite dhe si janë përkrahur këto kërkesa. Madje, krijohen anomali, si p.sh. numri i kërkesave në vitin 2024 rezulton 16 kërkesa, ndërkaq në vitin 2025 janë 157 kërkesa. Nëse ka ndodhur kjo, a do të duhej të paraqitej një analizë për faktorët që kanë ndikuar në këto ndryshime?

Banimi kolektiv dhe banimi social

Edhe pse draft-programi kryesisht fokusohet te banimi social, në të janë paraqitur edhe fotografi dhe të dhëna nga banimi në bashkëpronësi. Kërkojmë që, nëse këto të dhëna inkorporohen, të ofrohet një pasqyrim i plotë, ose të largohen nga dokumenti.

Nëse planifikohet që programi të shtrihet edhe në këtë kategori, duhet të paraqiten informata edhe

për ndërmarrjen publike banesore (statusi, gjendja, forma e menaxhimit), si dhe të vendosen objektiva, përfshirë edhe ato të sigurisë publike (hidrantët, rrjeti elektrik etj.).

Grupet e cenueshme

Në dokument nuk prezantohet asnjë e dhënë, objektive, veprim apo program i veçantë që lidhet me komunitetet pakicë apo me grupet tjera, si personat me aftësi të kufizuara, gratë viktime të dhunës apo nënat vetëushqyese.

Edhe pse në dokument i referoheni Strategjisë për Avancimin e të Drejtave të Komunitetit Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022–2026, ky dokument nuk ka adaptuar asgjë për përmbushjen e disa nga veprimet që kërkohen nga komunat.

Ndërkaq, në aspektin e barazisë, ajo paraqitet vetëm si nocion i përgjithshëm, pa pasur në konsideratë hartimin e politikave nga perspektiva gjinore.